



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

Nr. 9-105

Data: 31.05.2016.

Në bazë të nenit 23 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe neneve 15 dhe 16 të Pedagogjik të Kosovës, Këshilli Drejtues nxjerr këtë:

RREGULLORE

PUNE E KËSHILLIT DREJTUES TË INSTITUTIT PEDAGOGJIK TË KOSOVËS

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregulore definohet fushëveprimi i KD-së në funksion të mbikëqytjes, menaxhimit dhe të ndihmës së Institutit Pedagogjik (në tekstin e mëposhtëm IPK), në zbatimin e akteve normative dhe në përmbushjen e planit të punës.

Neni 2

Themelimi i Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues (në tekstin e mëposhtëm KD) themelohet në bazë të nenit 23 të Statutit të IPK-së. Mënyra e organizimit të punës dhe e funksionimit të Këshillit Drejtues, përcaktohet me Rregullore të veçantë, të cilën e harton KD.

Neni 3

Përbërja dhe zgjedhja e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues është organ kolegjal qeverisës i Institutit Pedagogjik të Kosovës,
2. Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë.
3. Drejtori i IPK është anëtar i KD sipas detyrës zyrtare.
4. Dy anëtarë të KD emërohen nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
5. Dy anëtarë të Këshillit Drejtues zgjidhen nga personeli i IPK-së me anë të votimit të fshehtë.
6. Të gjithë anëtarët e stafit të IPK-së kanë të drejtë të zgjidhen për anëtarë të Këshillit Drejtues.
7. Votimi për anëtarë të Këshillit Drejtues mund të bëhet vetëm atëherë kur janë prezent në mbledhje së paku dy të tretat (2/3) e personelit të IPK-së.
8. Për të hy në garë për anëtarë të KD duhet të propozohen 5 (pesë) anëtarë nga personeli i IPK-së, të cilët i nënshtrohen votimit të fshehtë.
9. Dy anëtarë nga personeli i IPK-së të cilët marrin më së shumti vota bëhen anëtarë të KD.
10. Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues zgjatë tre (3) vjet.
11. Anëtarët e KD mund të rizgjidhen vetëm edhe për një mandat.
12. Anëtarët e KD ushtrojnë detyrën e tyre bazuar në respektimin e plotë të lirisë dhe pavarësisë profesionale në marrjen e vendimeve.
13. Në mbledhjen e parë verifikohet lista e anëtarëve të KD.
14. Nëse KD konstaton se ndonjëri nga anëtarët nuk është zgjedhur në mënyrë të rregullt ose ekziston ndonjë konflikt interesi, kërkohet nga MASHT që të dërgohen propozime të tjera më së largu deri në dy javë.
15. Nëse ndonjëri anëtar i KD i emëruar nga Ministri tërhiqet, për ndonjë arsye, kërkohet që në afat prej dy javësh ta emërojë një anëtar tjetër.
16. Nëse ndonjëri anëtar i KD-së i zgejdhur nga IPK, tërhiqet për cilën do arsye, apo largohet nga IPK, atëherë brenda dy javësh IPK të propozon anëtarin/rët e rinjë të zgjedhur sipas të njëjtave procedura të votimeve në përshtatshmëri me pikat 5 – 9 të këtij neni.

Neni 4

Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit Drejtues

1. Mbledhjen e parë të Këshillit Drejtues e thërret dhe e udhëheqë drejtori i Institutit.
2. Në mbledhjen e parë, KD zgjedh nga radhët e veta kryetarin e KD-së.
3. Kryetari i KD zgjedhet me shumicën e votave të hapura të anëtarëve të Këshillit Drejtues.
4. Kryetari i KD zgjedhet me mandat trevjeçar me mundësi të ri-zgjedhjes edhe për një mandat tjetër.
5. KD zgjedh edhe nënkryetrin e KD me të njëjtën procedurë si në pikat 2,3 dhe 4 të këtij neni.

Neni 5

Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Drejtues

1. KD miraton Statutin dhe aktet normative të Institutit pas marrjes së pëlqimit paraprak nga MASHT-i.
2. Miraton Rregulloren e brendshme të punës së IPK.
3. Miraton planin vjetor të punës dhe planin financiar të IPK.
4. Shqyrton dhe aprovon raportin vjetor të punës dhe raportin financiar të IPK.
5. Përgatit raport me shkrim dhe e vlerëson punën e IPK.
6. Ndërmerr masa për organizimin dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në IPK.
7. Zgjedh dhe shkarkon drejtorin e IPK në bazë procedurave të përcaktuara me Statut të IPK.
8. KD, drejtori dhe Këshilli Shkencor bashkëpunojnë dhe i koordinojnë punët për zhvillimin e projekteve profesionale, hulumtuese të Institutit dhe aftësimin profesional të stafit.
9. Këshilli drejtues për punën e vet përgatit raport me shkrim për Ministrin;
10. Shqyrton dhe vendos për kërkesat e punëtorëve të ndërlidhura me veprimtarinë e tyre në IPK.
11. Vendosë edhe për çështje të tjera në bazë të UA dhe Statutit.
12. Vendimet për çështje të rëndësishme për IPK, KD i merrë me shumicë absolute të votave të anëtarëve.

Neni 6

Mbledhjet e Këshillit Drejtues

1. Mbledhjen e KD e thërret dhe e kryeson kryetari i KD.
2. Në mungesë të kryetarit, mbledhjen e udhëheqë nënkryetari e në mungesë të nënkryetarit, anëtari më i vjetër në KD.
3. KD mban mbledhjet e veta të rregullta më së paku katër herë brenda vitit.
4. Rendin e ditës në mbledhje e paraqet kryetari i KD.
5. Kryetari mund të thërret mbledhje edhe sipas nevojës.
6. KD mund të mbajë mbledhje të jashtëzakonshme, në çfarëdo kohe sipas procedurave të parapara dhe sipas nevojës.
7. Ftesën për mbledhje dërgohen me shkrim, e-mail ose në formë tjetër, më së paku 48 orë përpara.
8. Kryetari është i obliguar ta thërret mbledhjen nëse këtë e kërkojnë dhe e arsyetojnë me shkrim një e treta e anëtarëve të KD.
9. Të gjithë anëtarët e KD janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhje.
10. Në mbledhje të KD anëtarët duhet të votojnë personalisht.

11. Para se të fillojë mbledhja e KD anëtarët nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes, e cila është pjesë integrale e procesverbalit.
12. Anëtari i KD mund të mungojë në mbledhje vetëm për shkaqe të arsyeshme.
13. Për mosardhjen në mbledhje anëtari i KD duhet paraprakisht ta njoftojë kryetarin.
14. Anëtari i KD që mungon në tri mbledhje radhazi, pa arsyetim, humb mandatin e të qenit anëtar i KD.
15. Me ftesë të KD në takime mund të marrin pjesë edhe anëtarë tjerë të IPK-së, por pa të drejtë vote.
16. Në rastet kur Këshilli Drejtues dhe drejtori i Institutit nuk mund të pajtohen për ndonjë çështje të rëndësishme, kryetari i Këshillit drejtues mund ta ndërpresë mbledhjen dhe të kërkojë zyrtarisht qëndrimin e Ministrit.

Neni 7

Mbajtja e procesverbalit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues

1. Në çdo mbledhje të KD mbahet procesverbali.
2. Procesverbali nënshkruhet nga kryesuesi i mbledhjes dhe procesmbajtësi.
3. Procesverbali duhet të përmbajë këto elemente:
 - 2.1 Vendin, datën dhe kohën e fillimit dhe mbarimit të mbledhjes;
 - 2.2 Rendin e ditës;
 - 2.3 Listën e pjesëmarrësve;
 - 2.4 Të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse;
 - 2.5 Shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes;
 - 2.6 Dokumentet shtesë duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit si aneks;
3. Procesverbali duhet të përgatitet brenda një jave pas mbledhjes së KD dhe si ekstrakt duhet t'iu dërgohet anëtarëve të KD me rastin e dërgimit të materialit për mbledhjen e ardhshme të KD.
4. Procesverbali miratohet në mbledhjen e ardhshme të KD.
5. Procesverbali ruhet në arkiv të IPK-se me materialet shqyrtuese sipas pikave të rendit të ditës si dokument afatgjatë.

Neni 8

Zbatimi i rregullores

Dispozitat e kësaj Rregulloreje vlejné për të gjithë anëtarët e KD dhe për personat e tretë të ftuar ose të angazhuar në procedurat, funksionimin dhe punën e KD.

Neni 9

Mbikëqyrja e zbatimit dhe interpretimi i Rregullores

1. Për zbatimin e drejtë të kësaj rregulloreje kujdeset Kryesuesi i KD.
2. Interpretimin autentik të kësaj Rregulloreje e bën Zyra Ligjore në MASHT.

Neni 10

Ndryshimet dhe plotësimet

Çd ndryshim dhe plotësim i kësaj Rregulloreje duhet të bëhet sipas procedurës së njejtë të nxjerrjes dhe të miratimit.


Neni 11

Hyrja në fuqi

Rregullorja hyn në fuqi pas miratimit nga KD dhe nënshkrimit nga kryetari.

Datë, 31.05 2016

Ramush Lekaj,


Kryetari i KD të IPK-së